



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË
OPŠTINA VITINA, MUNICIPAL VITI
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

04.Nr.22/18

Më datë :29.05.2018

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Nenit 14. par.2. të Ligjit për Shëndetësi Nr.04/L125, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik , dhe Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Viti, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK

Institucioni:

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Viti

Titulli i vendit të punës:

Dy (2) infermier/e të përgjithshme – për teren (punkt shëndetësor).

Dy (2) Ass.Stomatologjisë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare.

Kategoria dhe grada e vendit të punës: - Koeficienti – 4.80, H-68

Orari: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Sipas Ligjit të punës nr. 03/L-212

Detyrat dhe përgjegjësitë për vendet e punës Infermier-e të përgjithshme:

Pranon triazhon dhe informon pacientin hap kartelën shëndetësore dhe merr anamnezën orientuese, aplikon terapinë parenterale, i.m.i.v. sub kutan, aplikon infuzionet , bënë inhalimin , përpunimin e plagës, përcjellë kalendarin e imunizimit aplikon në dhënien e oksigjenit, bënë audiogramet e nevojshme etj. Kryen edhe punë të tjera sipas sistematizimit të vendit të punës. Për punën e vet i përgjigjet shefit të shërbimit dhe infermieres përgjegjëse.

Detyrat dhe përgjegjësitë për vendet e punës Ass.Stomatologjisë:

Vendos kontaktin e parë me pacientin ,evidenton të dhënat e nevojshme mjekësore .E përgatit dhe e mirëmban aparaturën stomatologjike ,instrumentet dhe mjetet tjera për punë. Bashkëpunon me mjekun stomatolog dhe i ndihmon në të gjitha ndërmarrjet stomatologjike ,koordinon punën dhe bashkëpunon me teknikët e dhëmbëve .Kryen edhe punë të tjera sipas sistematizimit të vendit të punës. Për punën e vet i përgjigjet shefit të shërbimit dhe infermieres përgjegjëse.

Për vendet e punës Infermier-e të përgjithshme kërkohet:

- Shkollën e mesme të mjekësisë - Drejtimi i përgjithshëm
- Bachelor, - Dega infermieri e përgjithshme;
- Kandidati/ja duhet të ketë Licencën e Punës.

Për vendet e punës Ass.Stomatologjisë kërkohet:

- Shkollën e mesme të mjekësisë - Drejtimet stomatologjike.
- Kandidati/ja duhet të ketë Licencën e Punës.

Dokumentet e kërkuara për të gjithë kandidatët:

- Kopjet e diplomës së shkollimit të kryer
- Kopjen e licencës së punës
- Kopjen e letërnjoftimit apo të pasaportës
- Çdo dokument tjetër apo certifikatë trajnimi që kandidati/ja e vlerëson të nevojshme që i përshtatet kushteve dhe kriterëve të përcaktuara më lartë.
- Ekstrakti i lindjes,
- Çertifikatën që ndaj tij/saj nuk zbatohen hetimet,
- Dëshmi mbi njohjen bazike të punës me kompjuter; - e dëshirueshme

Komuna e Vitisë ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Aplikacionet e pa kompletuara sipas konkursit si dhe ato që arrin pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

Detyrat e punës për profilet e kërkuara me konkurs janë parashikuar me Ligjin e Shëndetësisë , Statutin e QKMF-së dhe Qarkoren Informative 02/2017 nga Ministria e Shëndetësisë.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrën e Arhivës të Komunës së Vitisë nr.1

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë pas shpalljes.